



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 48

Tiranë – E hënë, 17 dhjetor 2018

PËRMBAJTJA

		Page
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1281, datë 13.12.2018	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të Bashkisë Bajram Curri, të shoqërisë “Albminiera” sh.a., të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, të Bashkisë Kolonjë dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.....	3
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1281, datë 13.12.2018	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenëve të Policisë, Tiranë.....	6
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 8364, datë 17.12.2018	Shpallje për 1 vend vakant për pozicionin specialist i Sekretarisë Gjyqësore në këtë institucion dhe 1 vend vakant për pozicionin specialist protokoll-arkiv.....	7
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 8364/1, datë 17.12.2018	Shpallje për pozicionin këshilltar ligjor në këtë institucion.....	8

**NJOFTIM**

Nr. 1281, datë 13.12.2018

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL TË BASHKISË
BAJRAM CURRI, TË SHOQËRISË
“ALBMINIERA” SH.A., TË DREJTORISË
SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE
MATERIALE TË SHTETIT, TË
DREJTORISË SË SHËRBIMIT PYJOR,
TË BASHKISË KOLONJË DHE TË
MINISTRISË SË FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, kapitulli III, shpall për shitje me VAM të ulur, si më poshtë:

Në zbatim të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës

1. Në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Objekte të Agjencisë Kombëtare të Duhan Cigareve	Cërrik	19 175 889	16 693 733	2 482 156	5 924	1 344	8.1.2019	09:00	DDPP

2. Në administrim të Bashkisë Bajram Curri

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Ish-Këshilli Popullor	Bajram Curri	9 094 860	8 467 405	627 455	355	263.3	8.1.2019	10:00	DDPP

3. Në administrim të Shoqërisë “Albminiera” sh.a.

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Magazinë qendrore	Memaliaj, Tepelenë	8 693 920	8 197 420	496 500	3972	424.8	8.1.2019	11:00	DDPP



4. Në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit

Nr.	Emërtim i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Objekte të Agjencisë së Rezervave Materiale të Shtetit	Fushë Peshtan, Berat	26 097 837	18 290 481	7 807 356	4932	1657	8.1.2019	12:00	DDPP

5. Në administrim të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	5 objekte “Ndërtesë e degës teknike, magazinë qendër, kapanonet e makinave, kapanonet e makinave (Tojota) kapanon rrëshirë (magazinë)”	Dibër	16 960 156	14 414 804	2 545 352	746	746	8.1.2019	13:00	DDPP

6. Në administrim të Bashkisë Kolonjë

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Ish-shkolla 8-vjecare Rehovë	Kolonjë	4 550 685	4 273 917	276768	2 976	231	8.1.2019	14:00	DDPP

7. Në administrim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Magazinë ambalazhi	Bajram Curri, Tropojë	782 425	542 681	239 744	128	128	8.1.2019	15:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë Komisionit të Ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë Komisionit të Ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimsht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish- Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimsht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandat pagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al.



NJOFTIM

Nr. 1281, datë 13.12.2018

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM
TË INSTITUTIT TË PËRGATITJES SË
QENËVE TË POLICISË, TIRANË**

Në zbatim të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, i ndryshuar, shpall për shitje me VAM të ulur si më poshtë:

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenëve të Policisë, Tiranë

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
					Data	Ora	Vendi
1	Qeni “Doner”	3.10.2017	Tiranë	7,500	9.1.2019	08:30	DDPP
2	Qeni “Tom”	4.11.2017	Tiranë	7,500	9.1.2019	09:00	DDPP
3	Qeni “Kleo”	12.5.2017	Tiranë	7,500	9.1.2019	09:30	DDPP
4	Qeni “Dakota”	3.10.2017	Tiranë	7,500	9.1.2019	10:00	DDPP
5	Qeni “Jona”	3.10.2017	Tiranë	7,500	9.1.2019	10:30	DDPP
6	Qeni “Diva”	3.10.2017	Tiranë	7,500	9.1.2019	11:00	DDPP
7	Qeni “Orsa”	3.10.2017	Tiranë	7,500	9.1.2019	11:30	DDPP
8	Qeni “Xara”	4.11.2017	Tiranë	7,500	9.1.2019	12:00	DDPP
9	Qeni “Luna”	12.5.2017	Tiranë	7,500	9.1.2019	12:30	DDPP
10	Qeni “Maxhi”	7.5.2016	Tiranë	7,500	9.1.2019	13:00	DDPP
11	Qeni “Lata”	15.9.2012	Tiranë	7,500	9.1.2019	13:30	DDPP
12	Qeni “Viola”	4.6.2010	Tiranë	4,000	9.1.2019	14:00	DDPP
13	Qeni “Sonja”	10.6.2010	Tiranë	4,000	9.1.2019	14:30	DDPP
14	Qeni “Pana”	18.5.2012	Tiranë	5,000	9.1.2019	15:00	DDPP
15	Qeni “Pata”	17.3.2012	Tiranë	5,000	9.1.2019	15:30	DDPP
16	Qeni “Busan”	15.11.2010	Tiranë	4,000	9.1.2019	16:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë Komisionit të Ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Garancinë bankare** apo mandatpagesën në original që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën shpallur për shitje, i konfiskohet 20 % e

garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë www.financa.gov.al.

**NJOFTIM****Nr. 8364, datë 17.12.2018****KOMISIONI I PAVARUR
I KUALIFIKIMIT
SHALL 1 VEND VAKANT PËR
POZICIONIN SPECIALIST I
SEKRETARISË GJYQËSORE NË KËTË
INSTITUCION**

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e specialistit të Sekretarisë Gjyqësore, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: III-b.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë në Drejtësi.

b) Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

c) Të kenë të paktën tri vite përvojë pune në profesion.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi.

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuar).

4. Dëshmi penaliteti.

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 10 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën: Rruga e Kavajës, Ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna–premtë ora 8:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

**KOMISIONI I PAVARUR
I KUALIFIKIMIT
SHALL 1 VEND VAKANT PËR
POZICIONIN SPECIALIST
PROTOKOLL-ARKIV**

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e specialistit të protokoll-arkivit, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: IV-a.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) Të zotërojë diplomë të arsimit të lartë.

b) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

c) Të ketë të paktën tri vite përvojë pune në profesion.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidati duhet të plotësojë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidati duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.



Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi.
2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.
3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuar).
4. Dëshmi penaliteti.
5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 10 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna–premtë ora 8:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

NJOFTIM

Nr. 8364/1, datë 17.12.2018

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT NJOFTON PERSONAT E INTERESUAR TË APLIKOJNË PËR POZICIONIN KËSHILLTAR LIGJOR NË KËTË INSTITUCION

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: 80% e G3.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë

“Master i Shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë diplomë të njësuar sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave.

- b) Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

- c) Të ketë shtatë vite përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose në administratën publike.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi.
2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.
3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune (origjinale ose të noterizuar).

4. Dëshmi penaliteti.

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 20 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna–premtë, ora 8:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2018